



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	12.09.2023	25.09.2023	2023/0669
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Donijeta Sogojeva	13.09.2023		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 08.09.2023, OE “” Profitech ” SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0669, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Qendra mobile per kontrollim teknik te automejteve ne rruge.” me nr. të prokurimit: "205-23-6058-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E INFRASTRUKTURES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 500,000.00 €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 13.06.2023; data e hapjes së ofertës: 28.07.2023, data e njoftimit mbi vendimit e AK-se: 17.08.2023, data e njoftimit të me letër standarde: 17.08.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

NENI 1;6;13 59; 60 , 65 dhe 69.

KRITERET PËR VLERËSIM

a) Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 . b) Vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës . c) Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmerisë" - të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës . d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare a) Deklarata nën betim nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit – Aneksi 2 . b) Vërtetim nga Administrata Tatimore . c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – original kopje . d) Vërtetimin nga Gjykata Themelore – original ose kopje . Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

a) Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit; (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)

b) Certifikata e TVSH-së (vetëm për kompanitë vendore)

a) Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit

b) Kopja e certifikatës së TVSH-së

Kapaciteti ekonomik dhe financiar 1. OE duhet të ofroj dëshmi se qarkullimi vjetor i OE gjatë 3 viteve të fundit (2020, 2021 dhe 2022) ka qenë në vlerë jo më pak se 800,000.00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare 1. Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit.

1. Menaxheri i Projektit (personi kontaktues) 2. Lista e kontratave të realizuara dhe perfunduara për periudhën e shkuar tre vjeçare (2020, 2021 dhe 2022) jo më pak se 700,000.00 € . 3. Katalog ose broshurë me ilustrime foto dhe me përshkrim detaj të pajisjes me të cilën mundësohet vlerësimi i specifikave teknike të ofruara . 4. Projekti i detajuar i cili përmban të gjitha pajisjet, se si duket një qender mobile dhe si do të funksionoj.

Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1 - CV e nënshkruara nga inxhinieri, kontrata e punës me ofertuesin . Dëshmia 2. Kopje të kontratave dhe Procesverbalet e pranimit përfundimtar të pajisjeve, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të

realizuara per periudhën e shkuar tre vjeçare, te shoqruara me referenca dhe proqesverbale te pranimit te pajisjeve. 3.Katalog broshure me detajet e nevojshme për vlerësim. 4. Deshmija 4.- OE duhet te prezantoj një projekt detaj se si do te funksionj kjo qender mobile per realizimin e qellimit te ketij projekti.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontrate eshte i përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " Profitech " SH.P.K.

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – Ministria e Infrastrukturës nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-së, me këtë rast ka rekomanduar për

kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes së tenderit.

OE ankues me datën: 17.08.2023, ka pranuar vendimin e AK-se dhe letrën standarde ku AK-ja e ka eliminuar me arsyetimin:

Operatori Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në piken 4. Projekti i detajuar i cili përmban të gjitha pajisjet, se si duket një qender mobile dhe si do të funksionoj. Dëshmia 4.- OE duhet të prezantojë një projekt detaj se si do të funksionoj kjo qender mobile për realizimin e qëllimit të këtij projekti. Operatori ekonomik nuk ka prezantuar Projektin e detajuar sipas kërkesës të FDT-se. Nuk keni ofruar deklaratën për Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik sipas Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik paragrafi 26.1 në piken c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veprave në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; ju si gupe i operatorëve ekonomik keni paraqitur Burim Vrajolin i cili nuk është partner në grupin e operatorit ekonomik. Sipas Neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve i UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Mungon deklarata nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit për autorizim të partnerit udhëheqës	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
--	---	---------------------

Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyetimit të AK-se, se konzorciumi në fjalë nuk ka ofruar deklaratën me të cilën caktohet/autorizohet partneri udhëheqës i cili do të vepronte në emër të grupit, nuk qëndron sepse në piken C të deklaratës për themelimin e konzorciumit është caktuar si udhëheqës i konzorciumit Burim Vrajolli, i cili në qartifikatën e biznesit është pronar i Profitech. Prandaj ky pretendim i OE është i qëndrueshëm.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk i ka dorëzuar deklaratat e themelimit të konzorciumit, eksperti shqyrtues, sqaron se deklaratat e themelimit të grupit të operatorëve ekonomik, i rekomanduari për kontratë i ka ofruar sipas nenit 71 të LPP-se. Prandaj, nuk qëndron ky pretendim.

Pashtu sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari për kontratë nuk i ka ofruar kontratat dhe referencat sipas kërkesës së dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse vetëm lideri i konzorciumit ka ofruar liste të kontratave me mbi 700,000.00 euro, dhe fakti që ka qenë si nënkontraktor nuk përbën element që të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, sepse eksperti shqyrtues bazohet në kërkesën e dosjes së tenderit.

Pashtu OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë duhet të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit sepse në informatorin e certifikatës së biznesit, i rekomanduari për kontratë nuk e ka

veprimtarinë adekuate. Ky pretendim nuk qëndron sepse nuk është kërkesë e dosjes se tenderit dhe eliminimit për një kërkesë e cila nuk është parashtruar ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontrate është ne kundërshtim me paragrafin 3 te nenit 56 te LPP-se.

OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e ka dorëzuar deklaratën e specifikimit teknike sipas pikës 3.1 te dosjes se tenderit, kjo nuk qëndron sepse ne fajllin ku e ka ngarkuar deklaratën e themelimit te konzorciumit ne faqen nr. 6 e ka dhënë deklaratën sipas nenit 3.1 te FDT-se.

Eksperti teknik:

Pretendimi ankimor se Operatorit Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne piken 4. Projekti i detajuar i cili përmban te gjitha pajisjet, se si duket nje qendër mobile dhe si do te funksionoj. Dëshmija 4. - OE duhet te prezantoj nje projekt detaj se si do te funksionoj kjo qender mobile per realizimin e qellimit te ketij projekti. Operatori ekonomike nuk ka prezantuar Projektin e detajuar sipas kërkesës te FDT-se. Ne në dosje të tenderit e kemi prezantuar ofertën teknike në të cilën janë të specifikuar të gjitha pajisjet e ofruara një nga një të qendrës mobile, si dhe katalogjet për secilin pozicion veç e veç dhe katalogun në të cilën shihet se si duket dhe si funksionon qendra mobile, që do të thotë se është ofruar çdo detaj në lidhje me qendrën mobile të ofruar.

Si dëshmi të bashkangjitur mund të gjeni dokumentet te cilat janë pjesë e tenderit:

Katalogu (emërtimi i dokumentit):

7. General Catalogue - MTL_Mobile_Test_Line_ENG_R3.pdf

Oferta Teknike (emërtimi i dokumentit):

8. Technical offer - MTL - Mobile trucks, buses, heavy-duty vehicles & cars inspection line.pdf

Katalogjet për secilin pozicion (emërtimi i dosjeve)

13. Katalogjet 1.rar

14. Katalogjet 2.rar

Eksperti teknik: Pretendimi ankimore i OE ankues se jemi eliminuar pa te drejte, është i bazuar sepse projekti i detajuar eshte ne perputhje me kerkesat e dosjes se tenderit.

7. General Catalogue - MTL_Mobile_Test_Line_ENG_R3.pdf

8. Technical offer - MTL - Mobile trucks, buses, heavy-duty vehicles & cars inspection line.pdf.

Pretendimi ankimor se në Specifikacionet teknike të detyrueshme, neni 3.1, pika a) është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a) Deklaratën për specifikacionet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Grupit të OE të rekomanduar për kontratë i mungon Deklarata e Përputhshmërisë.

Pretendimi ankimor: Me rastin e përzgjedhjes së numruesit të grimcave për jemi përcaktuar për teknologjinë CPC. Pajisja mund të jetë e cilit do prodhues i cili i plotëson kushtet si në vijim: Certifikatën e konformitetit si dokument i cili dëshmon se PN është egzaminuar/ miratuar në përputhje me kërkesat teknike dhe metrologjike të përcaktuara në dokumentet e aplikuara në BE. E lëshuar nga ndonjë prej vendeve të BE – së (psh. Holandë, Zvicër, Gjermani) të ofrohet bashkë me materialin tenderues. Grupi i OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë Certifikatë të Konformitetit si dëshmi.

Eksperti teknik:

Pretendimi ankimor i pa bazuar sepse OE i rekomanduar ka ofruar Certifikatën e Konformitetit nga KBS (Organ i Vleresimit të konformitetit) e lëshuar me 16.12.2022 dhe PTB (Instituti Federal Fiziko-Teknik), Institut Kombëtar i Metrologjisë.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE " " Profitech " SH.P.K.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Qendra mobile për kontrollim teknik të automejteve në rrugë." me numër të prokurimit: "205-23-6058-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E INFRASTRUKTURES

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" Profitech " SH.P.K.**

Florije Rexhepi



Donijeta Sogojeva